



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LEGJISLATURA V**

**Sesioni vjeshtor**

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës  
Mbledhja nr. 42

Prishtinë, më 07.12. 2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

**PROCESVERBAL**

**I Mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe  
Mbukëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës**

**Në mbledhje morën pjesë:** Daut Haradinaj, kryetar, Ganimete Musliu, zëvendëskryetare e parë, Rexhep Selimi, Anton Quni, Qerim Bajrami, Nuredin Ibishi, Zafir Berisha, anëtarë.

**Mungoi:** Bojan Mitiq, zëvendëskryetar i dytë

**Delegacioni nga Mbretëria e Jordanisë:** **Salameh Hammad** – Ministër i Punëve të Brendshme të Jordanisë; **Besnik Tahiri** – Drejtor Ekzekutiv i Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale; **Arianit Shehu** – Drejtor i NDI për Jordani; **Sean J. Osner** – Drejtor i Programit për Demokratizim, Qeverisje dhe Drejta të Njeriut, USAID/Ambasada Amerikane në Jordani; **Amjah Saleh** – anëtarë i delegacionit nga Ministria e Punëve të Brendshme të Jordanisë.

**Nga Staf mbështetës i Komisionit:** Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

**Mbledhjen e kryesoi,** Daut Haradinaj, kryetar i Komisionit.

*Kryesuesi i Komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.*

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

### **Takimi i Komisionit me delegacionin nga Mbretëria e Jordanisë**

**Kryetari**, fillimisht i uroi mirëseardhje z. Salameh Hamada, Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme nga Mbretëria e Jordanisë. Më tutje theksoi që nga ana e Republikës së Kosovës janë formuar institucionet e saj përfshirë edhe ato të sigurisë ku roli Komisionit është të mbikëqyr punën e tyre. Gjithashtu falënderoi për mbështetjen e dhënë nga ana e Mbretërisë së Jordanisë për kontributin e dhënë për Kosovën.

**Salameh Hamadam, Ministri i Punëve të Brendshme, Mbretëria e Jordanisë**, në fillim të fjalës së tij theksoi që është takuar me liderët kryesor të Kosovës përfshirë Presidentin, Kryeministri, Ministrin e Punëve të Brendshme dhe Kryetarin e Kuvendit. Gjithashtu theksoi që nga takimi që ka pasur me Ministrin e Punëve të Brendshme, është diskutuar mundësia për nënshkrimin e marrëveshjeve mes Kosovës dhe Jordanisë për bashkëpunimin në çështjet që janë problematikë e përbashkët. Më tutje theksoi që ngjarjet që ndodhin në rajon kanë ndikuar në shumë aspekte të cilat shpesh janë ndërlidhur me islamin, por që islami pasqyron paqen dhe ndalon çdo masë të dhunshme ndaj çdo kujt. Gjithashtu vlerësoi aspekte e politikës ndërkombëtare dhe ngjarjet të cilat janë duke ndodhur në Siri dhe ndikimin rus në këtë shtet dhe rrjedhën e ngjarjeve në Irak, duke shtuar se shoqëri duhet të tregohemi sy hapur me atë se çfarë është duke ndodhur në botë.

**Kryetari**, theksoi që sa i përket aspektit të luftimit të terrorizmit është hartuar baza ligjore që parandalon pjesëmarrjen në lufta jashtë vendit, ndërsa sa i përket të drejtës së besimit është e drejtë e secilit qytetarë të besoj dhe zgjedh besimin. Më tutje theksoi që në gjashtë muajt e fundit, nuk ka pasur qytetar të Kosovës që kanë shkuar në luftëra jashtë vendit dhe kjo është e arritur e madhe dhe se Kosova është anëtare e përbashkët me perëndimin në luftën kundër terrorizmit dhe jep kontributin edhe në rajon për të zgjidhur këtë çështje. Gjithashtu në Policinë e Kosovës janë njësitë e specializuara që merren me çështjet e terrorizmit dhe ka arritur të parandaloj veprime terroriste.

Më tutje theksoi që çështja e transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës është një aspekt tjetër, por nga ana e Listës Serbe janë paraqitur pengesa për të votuar këtë ligj, pro që në të ardhëm e afër do të bëhet ky transformim.

Gjithashtu kërkoi që përveç mbështetjes së deritanishme nga Mbretëria e Jordanisë, nga ana e shtetit të tyre të bëhet përkrahja për njohjen e pavarësisë së Kosovës sidomos nga vendet e lindjes së mesme vendeve të tjera që nuk e kanë njohur shtetësinë e Kosovës.

**Salameh Hamadam, Ministri i Punëve të Brendshme, Mbretëria e Jordanisë**, theksoi që do të përcjell mesazhet nga këtu, që Kosova të ketë mbështetjen për anëtarësimin në organizata e rëndësishme të fushës së sigurisë. Gjithashtu theksoi që vëmendje e veçantë duhet ti kushtohet xhamive dhe imamëve, pasi janë ata që transmetojnë mesazhe tek të rinjtë. Në mbyllje të fjalës

së tij shprehur mirënjohjen për mikpritjen si dhe duke ftuar për vizitë në Mbretërinë e Jordanisë për të parë nga afër mënyrën e organizimit shtetëror si dhe askete kulturore të këtij vendi.

**Nuredin Ibishi**, shtroi çështjen e mbështetjes nga Mbretëria e Jordanisë, lidhur me mbështetjen e për njësinë e helikopterëve në kuadër të Policisë së Kosovës. Duke qenë se kjo çështje është diskutuar edhe më herët në nivel zyrtar.

**Salameh Hamadam, Ministri i Punëve të Brendshme, Mbretëria e Jordanisë**, theksoi se edhe në Jordan ekziston kjo problematikë dhe konsideroi se në të ardhme mund të ulen së bashku për të diskutuar se si mund të fillojnë për të konsoliduar këtë njësi në kuadër të policisë. Duke shtuar se do të bisedon me Drejtorinë e Policisë në Mbretërinë e Jordanisë që të ftoj Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, që të ftoj dhe të bisedojnë për këtë çështje.

**Qerim Bajrami**, falënderoi z.Salameh duke vlerësuar që modelin e ushtrisë dhe policisë të cilën e ka Mbretëria e Jordanisë, është shumë i zhvilluar dhe do të ishte mirë që në këtë fushë të ndihmohet Kosova.

**Salameh Hamadam, Ministri i Punëve të Brendshme, Mbretëria e Jordanisë**, theksoi që modeli i organizimit në kuadër të policisë në Jordani është funksional duke përmendur edhe elemente mbështetëse që i ndihmon për një funksionim sa më efektiv, dhe në mbyllje të fjalës së tij falënderoi për mikpritjen dhe shkëmbimin e përvojave.

**Kryetari**, falënderoi për prezencën në Komision duke kërkuar mbështetjen nga Mbretëria e Jordanisë për përvojat më të mira në fushën e sigurisë.

*Pas përfundimit të pjesë së parë të takimit me delegacionin nga Mbretëria e Jordanisë, Kryetari njoftoi Komisionin për aktivitete e zhvilluara.*

**Kryetari**, njoftoi për takimin që do të ketë me përfaqësuesit e zjarrfikësve të Kosovës, të cilët kanë shprehur shqetësimin për kushtet e punës, pagesat, mënyra e funksionimit në nivel të Kosovës. Për këtë arsye propozoi mundësinë që nga ana e Komisionit të bëhet ndonjë amendamentur do që të ketë mundësia për të zgjidhur këtë çështje.

Ndërsa sa i përket transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura theksoi që është diskutuar mundësia që nëse do ketë prapë pengesa nga Lista Serbe, të ndërmerren veprime nga Komisioni për ndërrimin e misionit të FSK-së përmes ligjit, për këtë qëllim kërkoi përkrahjen edhe të anëtarëve të tjerë të komisionit dhe partive që përfaqësojnë. Gjithashtu propozoi që të realizohet një vizitë në stacionin policor në jug në Prishtinë, stacioni numër 4 si dhe vizitë pune në Sekretariatit e Këshillit të Sigurisë së Kosovës.

**Rexhep Selimi**, sa i përket çështjes së zjarrfikësve theksoi që zgjidhja më e mirë do të ishte ndryshimi i ligjit për të rregulluar këtë çështje, ndërsa zgjidhje më të shpejt dhe momentale do të mund të bënte Qeveria. Ndërsa sa i përket transformimit të FSK-së, propozoi që nëse e kanë të gatshëm Ministria e FSK-së projektligjin që do të mund të ndryshonte misionin e FSK-së, mund të ndërmarrin iniciativën dhe Komisioni më pas të kryej procedurat e ndryshimit.

**Nuredin Ibishi**, propozoi që të realizohet edhe një vizitë në Dhomën e Monitorimit të kalimeve kufitare në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ndërsa sa i përket transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura përmes ligjit duke i ndërruar misionin, propozoi që kjo çështje të ngritet edhe ne grupet parlamentare.

**Zafir Berisha**, propozoi që nëse nuk ka lëvizje sa i përket transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura të ndërmerret nismë nga Komisioni me qëllim që mos të zvarritet procesi i transformimit.

**Qerim Bajrami**, shtoi që përderisa nuk do të ketë shkelje të ndonjë rregulli Komisioni të ndërmerr veprimet për procesin e transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura, përmes ligjit. Ndërsa sa i përket zjarrfikësve, propozoi që mund të bëhet amendament gjatë shqyrtimit të buxhetit. Më tutje theksoi që në Restelicë në komunën e Dragashit ka pasur raste të vjedhjeve të shpeshta dhe propozoi që të realizohet një takim me komandantin e stacionit regjional të Policisë së Kosovës.

**Rexhep Selimi**, shtroi çështjen e ndërtimit e një murit të betonit në veri të Mitrovicës, ndërkohë që është një heshtje nga institucionet. Për këtë kërkoi që të jepet një qëndrim nga ana e Komisionit.

**Kryesuesi**, me këtë pikë të rendit të ditës, e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 11:05.

**E përgatiti:**  
**Njësia për Mbështetjen e Komisionit.**

**Kryetari i Komisionit,**  

---

**Daut Haradinaj**